



# Manual për menaxhimin e situatave epidemiologjike në strukturat akomoduese Viruset respiratore

2021



# Manual për menaxhimin e situatave epidemiologjike në strukturat akomoduese Viruset respiratore

2021

Ky manual është hartuar me mbështetjen e ISHP (Prof. Asoc. Albana Fico) në kuadër të projektit “Zbatimi i protokollit COVID-19 në higjienën dhe sigurinë ushqimore në bujtina, hotele, ferma dhe agroturizëm”, **financuar nga Bashkëpunimi Gjerman për Zhvillim GIZ, Programi për Zhvillimin e Qendrueshëm Rural.**

Financed by the German Government, through Deutsche Gesellschaft für  
Internationale Zusammenarbeit (GIZ) GmbH



Implemented by **giz** Deutsche Gesellschaft  
für Internationale  
Zusammenarbeit (GIZ) GmbH

# Tabela e përmbajtjes

<b>I. Hyrje</b>	<b>5</b>
A. Viruset respiratore	5
B. Mënyrat kryesore të përhapjes nga personi i infektuar me SARS COV-2 dhe viruset e tjerë respiratore	5
C. Mënyra e transmetimit të SARS COV-2 dhe viruseve të tjerë respiratore	5
D. Simptomat	6
<b>II. Masat paraprake (të përgjithshme)</b>	<b>7</b>
<b>III. Hapat që duhet të ndjekin hotelet ose strukturat akomoduese për të minimizuar ekspozimin ndaj viruseve respiratore (punonjës dhe klientë)</b>	<b>8</b>
A. Koordinator/ menaxheri	8
B. Punonjësit që shfaqin simptomat në punë	9
C. Ndani këshillat e mëposhtme me punonjës tuaj	9
D. Sëmundja e një punonjësi	10
E. Një klient raporton simptoma gripi/koronavirusi	10
F. Higjiena e personale duhet të përfshijë këto momente të rëndësishme:	11
G. Xhel-alkooli për duar	11
<b>IV. Hapat që duhet të ndjekin hotelet ose strukturat akomoduese për të minimizuar ekspozimin ndaj viruseve respiratore (ambientet)</b>	<b>12</b>
A. Dekontaminimi i dhomës së klientëve të infektuar	12
B. Pastrimi dhe dezinfektimi është i rëndësishëm dhe duhet të përfshihen sipërfaqet vijuese të kontaktit me duar	12
C. Vendosni shpërndarësit e alkoolit në vendet e mëposhtme si një masë paraprake minimale	13
D. Procedura e dekontaminimit të dhomës, pas check-out	13
<b>V. Shtojcat</b>	<b>15</b>
Programi i pastrimit dhe dezinfektimit - dekontaminimi i dhomës	15
Programi i pastrimit dhe dezinfektimit - të gjitha sipërfaqet e kontaktit	16
Programi i pastrimit dhe dezinfektimit - tualetet	17
Regjistri i klientëve me simptoma	18
<b>VI. Literatura</b>	<b>19</b>



# I. HYRJE

## A. Viruset respiratore

Viruset e respiratore, pasi infektojnë individin, shumohen në traktin e sipërm ose të poshtëm të frymëmarrjes, duke çuar në simptoma të ngjashme me ato të gripit të zakonshëm. Këto viruse janë zoonotike (kanë aftësinë për t'u shndërruar gjenetikiisht dhe të kalojnë nga kafshët tek njerëzit) gjë e cila shpjegon aftësinë e tyre për t'u transformuar në shtame që mund të çojnë në infektive masive (epidemi dhe pandemi).

Koronaviruset janë një familje e madhe virusesh, disa shkaktojnë sëmundje tek njerëzit dhe të tjerë qarkullojnë midis kafshëve, si: deve, mace dhe lakuriq nate. SARS-CoV-2 i shfaqur kohët e fundit nuk është i njëjtë me koronaviruset që shkaktojnë MERS ose SARS. Analizat gjenetike sugjerojnë se është pjesë e së njëjtës familje.

Për gripin e zakonshëm ka një larmi vaksinash të cilat sigurojnë një mbrojtje, ndërkohë që MERS-Cov dhe SARS-Cov janë ende të pa studiuar tërësisht dhe nuk ka vakcina specifike për parandalimin e tyre, duke çuar në vështirësi për grupe të prekshme si të moshuarit, shumë të rinj dhe persona me imunitet të ulët në të cilët infeksioni mund të jetë fatal.

## B. Mënyrat kryesore të përhapjes nga personi i infektuar me SARS COV-2 dhe viruset e tjerë respiratore janë nëpërmjet:

- pështymës, kollitjes dhe teshtitjes;
- kontakteve personale të drejtpërdrejta;
- duarve të ndotura dhe prekja prej tyre e gojës, hundës apo syve;
- në raste të rralla, infeksioni mund të ndodhë përmes kontaminimit fekal.

## C. Mënyra e transmetimit të SARS COV-2 dhe viruseve të tjerë respiratore

Rruga e infeksionit është nga thithja e aerosoleve që përmbajnë grimca infektive virale, si dhe nga kontakti me sende/ objekte që mund të mbajnë grimca virusi dhe më pas prekjen e fytyrës / gojës / syve.

Zakonisht viruset respiratore nuk transmetohen nëpërmjet ushqimit, por në çdo rast duhen respektuar praktikatat e mira të higjienës, duke shmangur kontaktin midis ushqimit të papërpunuar dhe atij të gatuar. Në kushtet e duhura, disa viruse mund të mbijetojnë ditë ose edhe javë në sipërfaqe të forta nëse nuk dezinfektohen tërësisht.

Mënyra e transmetimit të SARS COV-2 dhe viruseve të tjerë respiratorë janë:

- Kryesisht përhapet përmes ajrit (ajrore) kur një person teshtin ose kollitet.
- Më shpesh, përhapja ndodh nga një person tek tjetri nga kontaktet e ngushta (1-2 metra) dhe kryesisht përmes spërklave të prodhuara kur një person i infektuar kollitet ose teshtin.
- Këto spërkla mund të zbresin në gojë, hundë ose sy të njerëzve që janë afër ose mund të thithen në mushkëri.
- Infeksioni gjithashtu mund të ndodhë nëse një person prek një sipërfaqe të infektuar dhe pastaj prek sytë, hundën ose gojën e tij/saj.
- Nga personi në person përhapet nga kontakti i drejtpërdrejtë me një person të infektuar p.sh. kujdesi për një të sëmurë, të afërt anëtarët e familjes etj. si dhe duke qenë në afërsi me një individ simptomatik ose asimptomatik.

#### **D. Simptomat**

Simptomat e shumë viruseve respiratore shpesh janë të ngjashme me ato të gripit sezonal dhe kanë një periudhë inkubacioni të gjerë në varësi të personit të infektuar, kjo mund të zgjasë nga 2 ditë në 2 javë.

Në raste më të rënda, infeksioni mund të shkaktojë pneumoni, sindromë të rëndë respiratore akute, insuficiencë të veshkave, madje edhe vdekje.

Simptomat mund të përfshijnë:

- temperaturë më të lartë se 38 C
- kollitje
- gulçim
- dhimbje fyti
- dhimbje trupi
- dhimbje koke
- të dridhura dhe lodhje
- humbje shije dhe nuhatje (karakteristike për SARS COV-2)



## II. MASAT PARAPRAKE (TË PËRGJITHSHME)

Ka disa rregulla të përgjithshme që mund të ndihmojnë në parandalimin e përhapjes së infeksionit të cilat shkaktojnë infeksione respiratore.

### **Duhet të aplikohen këto hapa të përditshëm për të mbrojtur shëndetin tuaj:**

- Mbani një distancë të caktuar, të paktën 2 metër nga njerëzit e tjerë, veçanërisht kur kolliten, teshtijnë ose nëse kanë ethe, sepse virusi gjendet në spërklata e pështymës dhe mund të transmetohet nëpërmjet frymëmarrjes në distancë të afërt;
- Mënjaroni kontaktet e ngushta me këdo që ka temperaturë dhe kollë dhe janë të sëmurë;
- Kur kolliteni apo teshtini, mbuloni gojën dhe hundën me gropëzën e bërrylit ose shami letre;
- Hidheni menjëherë shaminë e letrës në koshin e plehrave dhe pastaj lani duart;
- Lani duart shpesh me ujë dhe sapun, veçanërisht pasi të keni kollitur ose teshtirë për të paktën 20 sekonda;
- Dezinfektuesit e duarve me bazë alkooli janë gjithashtu efektivë (përmbajtja duhet të jetë më e madhe se 60% etanol ose 70% izopropanol).
- Maskat e fytyrës ose mbulesat e fytyrës duhet të mbahen gjatë një pandemie;
- Të zbatohen me rigorozitet Protokollat e Sigurisë.



# III. HAPAT QË DUHET TË NDJEKIN HOTELET OSE STRUKTURAT AKOMODUESE PËR TË MINIMIZUAR EKSPOZIMIN NDAJ VIRUSEVE RESPIRATORE

(PUNONJËS DHE KLIENTË)

## A. Koordinator/ Menaxheri

Çdo njësi akomodimi apo hotel duhet të ketë një koordinator ose menaxher, i cili do të trajnohet nga autoritetet kompetente për të gjithë procedurën dhe masat parandaluese që duhet të ndërmerren me qëllim trajnimin nga ana e tij të stafeve respektive.

- Koordinator duhet të mundësojë një rregullore të brendshme në përputhje me protokollin e masave, do t'i caktojë detyra konkrete stafit si dhe do të marrë masa për furnizimin me mjetet dhe logjistikën e nevojshme.
- Duhet të trajnohet i gjithë stafi dhe anëtarët e ekipit mbi procedurat dhe masat paraprake dhe zbatimin e etiketës respiratore.
- Duhet të siguroheni që ata marrin informacion të azhurnuar dhe po marrin masat e nevojshme paraprake për të mbrojtur veten dhe klientët tuaj.
- Protokollin kërkon gjithashtu që tu matet temperatura të gjithë punonjësve dhe vizitorëve në çdo hyrje ambienti, dhe në rast temperature koordinatori apo menaxheri komunikon menjëherë me përfaqësuesit e NJVKSH (Njësia Vendore e Kujdesit Shëndetësor).
- Në çdo rast, i gjithë stafi duhet të pajiset përgjatë gjithë periudhës së shërbimit, me maska mbrojtëse.
- Pastroni dhe dezinfektoni plotësisht dhe rregullisht me solucione dezinfektuese të gjitha ambientet.
- Rekomandoni ekipet për të kaluar kohë shtesë duke dezinfektuar sipërfaqet e kontaktit me duar, të tilla si: tavolina, doreza, tryeza, kangjella, kabinat dhe butonat e ashensorit, telekomandat, telefonat, dhe çelësat e dritës.
- Mbani pecetat e pastrimit dhe pastruesit e duarve me bazë alkooli 60 % në vende të përshtatshme për klientët dhe pjesëtarët e ekipit në vende të tilla si recepsioni, zona e mëngjesit dhe zonat e pushimit.
- Anëtarët e ekipit me simptoma të ngjashme me gripin nuk duhet të paraqiten në punë, në mënyrë që të kufizohet kontakti me të tjerët dhe përhapja e virusit.



## **B. Punonjësit që shfaqin simptomat në punë**

Sigurohuni që punonjësit të njoftojnë menjëherë menaxherin e departamentit ose administratorin, nëse mendojnë se mund të kenë simptoma të ngjashme dhe të mos paraqiten në punë.

- Personeli i punësuar duhet të përdorë në çdo moment maskën mbrojtëse duke mbuluar hundën dhe gojën dhe të zbatojë protokollin e sigurisë.
- Sipas rastit Administratori / Personi Fizik ose Përgjegjësi i Autorizuar, kryen çdo ditë vetëvlerësimin personal dhe vlerësimin për prezencën e simptomave respiratore në personat e punësuar.
- Asnjë person me temperaturë 37.5 nuk duhet të lejohet të hyjë në subjekt.
- Nëse është e mundur të caktohet një dhomë ose zonë ku ata mund të izoloohen dhe të hapen dritaret herë pas here për një ventilimin sa më të mirë të dhomës.
- Punonjësi duhet të shmangë prekjen e njerëzve, sipërfaqet dhe objektet dhe këshillohet të mbulojnë gojën dhe hundën me pecete të disponueshëm kur kollitet ose teshtin dhe të vendosi pecetat në një qese pastaj ta hedhë në kosh.
- Nëse nuk kanë çfarëdo pecete të disponueshëm, ata duhet të kolliten dhe të teshtinin në bërrylin e tyre.
- Nëse ata kanë nevojë të shkojnë në tualet ndërsa presin ndihmë mjekësore, ata duhet të përdorin një banjë të veçantë, nëse është e disponueshme.
- Administratori / Personi Fizik ose Përgjegjësi i Autorizuar duhet të kontaktojë mjekun ose urgjencën (127) sipas gjendjes së punonjësit.
- Administratori/Personi Fizik ose Përgjegjësi i Autorizuar, duhet të sigurojë vazhdimisht dhe në çdo moment: sapun, letër për pastrimin e duarve, maskat, dorezat dhe dezinfektantë për pastrimin e sipërfaqeve si dhe kosha plehrash të mbyllur të cilët duhen pastruar çdo ditë.

## **C. Ndani këshillat e mëposhtme me punonjësin tuaj**

Këshilla për anëtarët e ekipit me simptoma të gripit ose të viruseve respiratore, Covid-19:

- Mos shkoni në punë nëse keni simptoma dhe shenja të këtyre virozave.
- Shmangni udhëtimet dhe zonat e mbushura me njerëz.
- Nëse keni dhimbje muskulore, kollë dhe temperature më të madhe se 38°C, flisni me mjekun tuaj.
- Mos e vizitoni institucionin e kujdesit shëndetësor derisa të këshilloheni me mjekun tuaj përmes telefonit.
- Ndiqni rekomandimet e mjekut tuaj në lidhje me trajtimin.
- Nëse jeni në karantinë (ju është thënë të qëndroni në shtëpinë tuaj dhe të shmangni kontaktet me të tjerë), përmbushni të gjitha kërkesat e karantinimit në shtëpi. Informoni të gjithë njerëzit me të cilët keni qenë në kontakt.
- Zbatimi me rigorozitet i Protokollit të Sigurisë.

#### **D. Sëmundja e një punonjësi**

- Ashtu si me çdo sëmundje, anëtarët e ekipit duhet të largohen nga mjedisi ku punojnë nëse nuk ndihen mirë dhe preken nga grip me simptoma të ngjashme të frymëmarrjes. Anëtarët e ekipit mund të kthehen në punë kur simptomat janë ulur dhe/ose të kenë një shënim mjekësor që konfirmon aftësinë për punë.
- Duhet lajmëruar autoritet shëndetësore (NJVKSH) për rastin e prekjes së një punonjësi
- Kur informoheni për punonjës pozitivë me Gripin /Coronavirus, duhet të kryhet dezinfektimi i mjediseve të punës duke përdorur një dezinfektues anti-viral të aprovuar.

*Shihni shtojcën 1 për detaje.*

#### **E. Një klient raporton simptoma gripi/koronavirusi**

Më poshtë janë procedurat e rekomanduara nëse një vizitor raporton simptoma të ngjashme:


- Nëse personi apo klienti shfaq simptoma, ky person duhet të karantinohet në një ambient të veçuar të godinës derisa të merren masat përkatëse nga shërbimet shëndetësore.
- Për çdo rast Administratori/Personi Fizik ose Përgjegjësi i Autorizuar për shëndetin në punë, lajmëron menjëherë strukturat përkatëse, veçanërisht Njësinë Vendore të Kujdesit Shëndetësor dhe Institutin e Shëndetit Publik.
- Administratori/Personi Fizik ose Përgjegjësi i Autorizuar në Hotel ose strukturë akomoduese, duhet të dijë të menaxhojë situatën duke zbatuar protokollet e sigurisë.
- Inkurajoni klientin që të kontaktojë menjëherë mjekun e tij ose të kontaktoni menjëherë 127-n.
- Ndiqni këshillat që merrni nga departamenti juaj shëndetësor lokal
- Mos e transportoni klientin në ndonjë vend tjetër, përveç, nëse drejtohet nga një këshilltar mjekësor/mjek.
- Nëse klienti largohet nga prona, por klientët e tjerë qëndrojnë në dhomën e njëjtë të hotelit, inkurajoni këta mysafirë të kontaktojnë menjëherë mjekun e tyre për këshilla.
- Mos lejoni asnjë anëtar të ekipit të hotelit për të hyrë në dhomë derisa të jetë dekontaminuar nga stafi i trajnuar.
- Dokumentoni detajet e secilit veprim të ndërmarrë.

## **F. Higjiena e personale duhet të përfshijë këto momente të rëndësishme:**

- Administratori/Personi Fizik ose Përgjegjësi i Autorizuar në Hotel, duhet të sigurojë higjienë korrekte të larjes së duarve.
- Para dhe pas ndërrimit të punës dhe në mënyrë periodike përgjatë punës
- Para, gjatë dhe pas përgatitjes së ushqimit
- Pas përdorimit të tualetit
- Pasi të keni kryer pastrimin e hundëve, pas kollitjes ose teshtitjes
- Pasi të keni veshur, prekur ose hequr maskën apo mbrojtësen e fytyrës
- Para dhe pas ndërprerjes së punës
- Pas prekjes së parave ose sendeve që janë trajtuar nga klientët, siç janë qeset ushqimore me një përdorim
- Para se të vishni dhe hiqni dorezat me një përdorim
- Të mos prekni sytë, hundën ose gojën

## **G. Xhel-alkooli për duar**

- Sipas rekomandimeve të OBSH-së dhe CDC-së, mënyra më e mirë për të parandaluar përhapjen e infeksioneve dhe për të ulur rrezikun e marrjes së infeksionit, është larja e duarve me sapun dhe ujë.
- Larja e duarve shpesh me ujë dhe sapun për të paktën 20 sekondat janë thelbësore, veçanërisht pas vajtjes në tualet, para ngrënies, pas kollitjes, teshtitjes, ose fryrjes së hundëve.
- Nëse sapuni dhe uji nuk janë të disponueshëm, OBSH dhe CDC rekomandojnë të përdoret një pastrues me bazë alkooli që përmban të paktën 60% etanol ose 70% izopropanol.



## IV. HAPAT QË DUHET TË NDJEKIN HOTELET OSE STRUKTURAT AKOMODUESE PËR TË MINIMIZUAR EKSPOZIMIN NDAJ VIRUSEVE RESPIRATORE

(AMBIENTET)

### A. Dekontaminimi i dhomës së klientëve të infektuar (pastrimi, lavaneria dhe hedhja e mbeturinave)

- Të bëhet një pastrim dhe dezinfektim gjeneral i dhomës së izolimit apo karantinimit ku ka qëndruar klienti.
- Pastrimi dhe dezinfektimi duhet të bëhet korrekt, duke veshur pajisjet mbrojtëse personale.
- Pasi të hiqni dorezat, lani duart me ujë të nxehtë me sapun për të paktën 20 sekonda dhe thajini plotësisht.
- Kur është e mundur, hapni dritare për të bërë ajrosjen e duhur dhe ventilimin e saj.
- Mbani sipërfaqet (sidomos tavolinat e shtratit dhe sipërfaqet në tualet) të pastra duke i fshirë ato me një dezinfektues të aprovuar anti-viral me përmbajtje të klorit aktiv apo klorur benzalkoni 10%, sipas udhëzimeve në etiketën e produktit.
- Të linjtat, enët e ngrënies dhe enët që u përkasin atyre që janë të sëmurë nuk duhet të përdoren përsëri pa u dezinfektuar më parë plotësisht.
- Lani të linjtat në një larje të nxehtë dhe thajini në një mjedis të nxehtë.
- Shmangni "përçafimin" e rrobave para larjes së tyre për të parandaluar kontaminimin e vetvetes.
- Sugjerohet që filtrat e ajrimit dhe ajrit të kondicionuar të pastrohen dhe dezinfektohen me lëndë viroicide.
- Pasi dhoma të pastrohet plotësisht dhe të dekontaminohet, dezinfektoni çdo pajisje pastrimi të përdorur.

### B. Pastrimi dhe dezinfektimi është i rëndësishëm dhe duhet të përfshihen sipërfaqet vijuese të kontaktit me duar:

- Dorezat e derës/kabinës
- Sipërfaqet e banjës
- Tualeti, bidetë dhe të gjitha dorezat e banjës/çezmës
- Tavolina dhe parmakë
- Telefonat, pajisjet kompjuterike duke përfshirë tastierat dhe maus-et.
- Kabinat dhe Butonat e ashensorit;
- Telekomanda të TV, minibar, etj.

- Për dezinfektimin e zonës publike, rekomandohet që kjo të ndërmerret dy herë në ditë
- Për pastrimin e tualetit publik, kimikati standard duhet të zëvendësohet me dezinfektuesi anti-viral si virocide, si pjesë e procedurave standarde.
- Dezinfektuesi anti-viral nuk do të përdoret në kuzhina për dezinfektimin e sipërfaqes së ushqimit.
- Në fund të turnit, parashikohet pastrim mekanik i detyrueshëm dhe dezinfektim me mjete që veprojnë ndaj virusit. Hotelierët janë të detyruar që në tualetet të mbajnë evidencë për realizimin e pastrimit.
- Produktet dezinfektuese të bazuara në hipoklorit përfshijnë formulime të lëngshme (hipoklorit natriumi), të ngurta ose pluhur (hipoklorit kalciumit).
- Produktet virocide kanë efikasitet të lartë në ambientet e hotelerive.
- Tualetet duhen të jenë të pajisur me letra higjienike dhe solucione dezinfektuese dhe detergjentë të ndryshëm.

### **C. Vendosni shpërndarësit e alkoolit në vendet e mëposhtme si një masë paraprake minimale:**

- Tavolina pritjeje përpara dhe sallë pritjeje (portier nëse ndodhet larg recepsionit);
- Tualetet publike dhe të personelit për meshkuj, femra dhe me aftësi të kufizuara;
- Hyrja në të gjitha pikat e F&B (Restorant, Sallone, Bare, pika ekskluziviteti brenda hotelit);
- Hyrja në SPA;
- Makina të hotelit.

Mbi secilin, vendosni një shenjë të laminuar me shkrimin e mëposhtëm:

*Xhel alkooli për duar.  
Ju lutemi dezinfektoni duart këtu!*

### **D. Procedura e dekontaminimit të dhomës, pas check-out**

- Të kryhet pastrimi, dezinfektimi i dhomës dhe të lihet e hapur për ajrosje dhe të ndërrohen të gjitha pajisjet e dhomës të vihen të dezinfektuara.
- Për të kryer një dekontaminim të saktë duhet të vishen pajisjet mbrojtëse personale si veshje njëpërdorimshme, doreza nitrile, maska respiratore apo kirurgjikale si dhe gamën e detergjentëve dhe dezinfektantëve disponibël në objekt.
- Hapni dritaret kur është e mundur për të lejuar hyrjen e ajrit të pastër
- Mbi shtrat, vendosni të gjitha të linjtat dhe jastëkun në çanta te posaçme.
- Hiqni perden e dushit (nëse nuk janë xham) dhe të linjtat e banjës, vendoseni në çanta
- Përdorni Makinën e Ozonit në dhomën e gjumit për një cikël, nëse është e disponueshme.
- Të gjitha enët dhe qelqet duhet të lahen me dezinfektues anti-virale si virocide
- Dekontaminoni të gjitha sipërfaqet e forta d.m.th. karriget dhe pjesët e sipërme të tavolinave, kornizat e dritareve, tavolinat e zhveshjes, komodinat, veshjet, telefonat, telekomandat, dorezat e dyerve, çelësin e dritës, me dezinfektues anti-viral.

- Sigurohuni që mini-bari është pastruar, d.m.th. hiqni sendet dhe pastroni me dezinfektues anti-viral.
- Dekontaminoni të gjitha zonat brenda banjës siç janë aspiratorët, rubinetet, dushi, dorezat, shinat e peshqirëve, koshat e mbeturinave duke përdorur një leckë të disponueshme dhe dezinfektues anti-viral.
- Pastroni tualetin me një leckë dhe kovë me detergjente dhe më pas me dezinfektantë si virocid apo klor sipas rekomandimeve të OBSH-se. (mundësisht të koduar me ngjyra).
- Të gjitha rrobat, dorezat, përparëset dhe maskat që janë veshur, duhet të vendosen në qese të dhe të asgjësohen.



## V. SHTOJCAT

### Programi i Pastrimit dhe Dezinfektimit - Dekontaminimi i Dhomës

Sigurohuni që dhoma të jetë e mbyllur për 72 orë pas ikjes së klientit para se të hyni në dhomë

VEPRIMI I KRYER	E KRYER	EMRI	FIRMA
Zhveshja e krevatit - vendosni të linjtat në çanta			
Mbulesa/jorgani dhe jastëkët			
Në rast se përdoret perde dushi duhet hequr e vendosur në çantën e veçantë			
Hidhni në mbeturina të gjitha printimet e dhomës			
Përdorni makinerinë e dezinfektimit me Ozon			
Të gjitha enët dhe qelqet u dezinfektuan me detergjentë anti-virale para larjes			
Minibari është pastruar, janë hequr sendet dhe pastruar me dezinfektues anti-viral			
Dekontaminoni sipërfaqet e forta dhe kontaktit në dhomë me dezinfektues anti-viral.			
Dekontaminoni sipërfaqet e forta dhe të kontaktit në tualet me dezinfektues anti-viral			
Dyshemeja e banjës u fshi			
Pastro tualetin si normalisht			
Të gjitha rrobat dorezat, përparëset dhe maskat (nëse vishen) - vendosen në qese të posaçme të "Biohazard" dhe hidhen në koshin e mbetjeve			

Ora kur mbaroi pastrimi i dhomës: \_\_\_\_\_

Kjo dhomë mund të përdoret më:

Datë: \_\_\_\_\_

Orë: \_\_\_\_\_

### Programi i Pastrimit dhe Dezinfektimit - Të gjitha Sipërfaqet e Kontaktit

Renditni të gjitha zonat në hotel që kanë sipërfaqe kontakti, kopjoni fletën dhe përdoreni çdo dy orë për të regjistruar pastrimin dhe dezinfektimi i zonave (pjesa e përparme dhe e pasme).

ZONA	ORA E PASTRIMIT	EMRI	FIRMA



## Programi i Pastrimit dhe Dezinfektimit - Tualetet

Përdorni këtë tabelë për të regjistruar pastrimin dhe dezinfektimin e të gjithë tualeteve publike në hotel (përdorni një orar për çdo tualet).

Tualeti: \_\_\_\_\_

ORA E PASTRIMIT	EMRI	FIRMA
00:00		
01:00		
02:00		
03:00		
04:00		
05:00		
06:00		
07:00		
08:00		
09:00		
10:00		
11:00		
12:00		
13:00		
14:00		
15:00		
16:00		
17:00		
18:00		
19:00		
20:00		
21:00		
22:00		
23:00		

## Regjistri i klientëve me simptoma

Përdoreni këtë listë për të regjistruar rastet e klientëve me simptoma

EMRI dhe MBIEMRI	NR. DHOMËS	DATË/ORA	SIMPTOMAT	KOMENTE

*SHËNIM: Ky manual është subjekt i ndryshimit në raport me ndryshimin e situatës epidemiologjike përsa i përket COVID-19!*



## VI. LITERATURA:

- Instituti i Shëndetit Publik ([www.ishp.gov.al](http://www.ishp.gov.al))
- Organizata Botërore e Shëndetit ([www.who.gov](http://www.who.gov))
- Qendra Evropiane për Parandalimin dhe Kontrollin e Sëmundjeve ([www.ecdc.gov](http://www.ecdc.gov))
- Shoqata Amerikane e Hotelit dhe Strehimit (<https://www.ahla.com/>)
- Gripi Pandemik - Anglisht

